



**HAL**  
open science

## Perspektivat dhe sfidat e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European

Enika Abazi

► **To cite this version:**

Enika Abazi. Perspektivat dhe sfidat e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European. Rakipi, Albert. Shqiperia në marrëdhëniet ndërkombëtare [Mapping Albania's International Relations Since 1912], AIIS Press, pp.361-380, 2013. halshs-01371299

**HAL Id: halshs-01371299**

**<https://shs.hal.science/halshs-01371299v1>**

Submitted on 26 Sep 2016

**HAL** is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.



**Albanian Institute  
for International Studies**

# SHQIPËRIA NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

**Editor Albert Rakipi**

# PERSPEKTIVAT DHE SFIDAT E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN

*Enika Abazi<sup>1</sup>*

Sfidat e integrimit të Shqipërisë në BE janë të ndryshme dhe jo domosdoshmërisht kanë të bëjë vetëm me përparimin e vendit në konsolidimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe të ekonomisë së tregut. Në këtë punim perspektivat e integrimit shihen në funksion të ndikimit të shumë faktorëve si çështjet e identitetit, ekonomisë, sigurisë, dhe të demokratizimit në nivel lokal, rajonal dhe evropian. Kjo qasje nxjerr një tablo të gjerë dhe realiste jo vetëm të sfidave me të cilat përballet Shqipërisë por dhe të perspektivës për integrim në Evropë.

## Hyrje

Në fakt, Ballkani dhe më konkretisht Ballkani Perëndimor, siç e quan atë Bashkimi Evropian pas integrimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në vitin 2007, është një nocion politik me shumë se sa një përkufizim gjeografik. Ballkani Perëndimor përfshin Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë dhe së fundmi edhe Kosovën. Gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë, Ballkani ishte zona ku ndahej Lindja me Perëndimin. Pas rënies së regjimeve komuniste në Evropën Lindore dhe Juglindore, që pasoi me firmosje të Traktatit të Mاستrihtit dhe themelimin e Bashkimit Evropian (BE) u rrit euforia për bashkimin me Evropën e bashkuar. Kështu, perspektiva e një të ardhme të përbashkët e Ballkanit në Evropën demokratike dhe të begatë dukej tashme më se e realizueshme.

Sot, rajoni i Ballkanit Perëndimor përbën një pjesë të pandashme të hapësirës së Evropës së re ku perspektivat e integrimit në BE nuk vihen

më në diskutim.<sup>2</sup> Por, përfshirja e vendeve të rajonit në BE mbetet ende e largët, pasi më parë duhet të zgjidhen çështjet e sigurisë dhe kufijve midis tyre dhe të thellohet bashkëpunimi dhe shkëmbimet reciproke në të gjitha fushat e aktivitetit shoqëror me qëllim integrimin në nivel rajonal, pa harruar këtu bërjen me cilësi të detyrave të tjera të shtëpisë që njihen tashmë si kriteret e Kopenhagenit dhe Madridit.<sup>3</sup>

Megjithatë duhet vënë në dukje se anëtarësimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor duket se ndikohen ndjeshëm edhe nga dinamikat e zhvillimeve në gjirin e vetë Bashkimit Evropian. Sot BE-ja e të 27-tëve dhe e më shumë se 500 milion rezidentëve është e dyzuar midis politikave të thellimit të integritit dhe atyre të zgjerimit. “Lodhja nga zgjerimit”<sup>4</sup> dhe përballja me problemin e “aftësive përthithëse” të BE-së, që u thelluan me dështimin e referendumeve mbi traktatin kushtetues në 2005-ën dhe anëtarësimin të Bullgarisë dhe Rumanisë më 2007-tën, natyrshëm gjeneruan thirrje dhe veprime për thellimin e integritit për kundrejt zgjerimit të mëtejshëm të BE-së. Ndërkohë, shtrirja e mëtejshme e BE-së drejt Lindjes dhe Juglindjes ka të bëjnë edhe me përgjigjet që do t’ju jepet çështjeve konceptuale të identitetit evropian në funksion të përcaktimit të Evropës dhe evropianëve,<sup>5</sup> të cilët të paktën në parim duhet të gëzojnë të drejtën të bëhen në një të ardhme qoftë edhe të largët pjesë e Bashkimit Evropian. E këtu mund të vazhdojmë me tej me debatet që merren me identifikimin e Evropës politike, ekonomike, kulturore etj. që e përshtjellon edhe më tej kuptimin e perspektivës së zgjerimit. Për më shumë opinioni publik në BE vazhdon të ketë rezervat e tij ndaj zgjerimeve dhe ky është një tjetër faktor jo në favor të integritit të Ballkanit Perëndimor.<sup>6</sup> Megjithatë Strategjia e Komisionit Evropian për Zgjerim e vitit 2005, është një përpjekje për t’iu përgjigjur pozitivisht perspektivave të zgjerimit në këtë gjendje lodhjeje duke siguruar vendet

2 “Western Balkans: Enhancing the European Perspective”. Communication from the Commission to the European Parliament and the Council. 2008-03-05. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/balkans\\_communication/western\\_balkans\\_communication\\_050308\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/balkans_communication/western_balkans_communication_050308_en.pdf). Retrieved 2008-04-08

3 The Copenhagen Criteria, DG Enlargement [http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement\\_process/accession\\_process/criteria/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/criteria/index_en.htm); [http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement\\_process/accession\\_process/criteria/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/criteria/index_en.htm)

4 Frank Schimmelfennig (Sept. 2008) “EU political accession conditionality after the 2004 enlargement: consistency and effectiveness,” *Journal of European Public Policy*, Volume 15, Number 6(20): pp. 918-937.

5 Anthon Smith, (1995) “National Identity and the Idea of European Unity,” *International*

kandidate nëpërmjet udhëzimeve për rrugën e tyre drejt pranimit në BE - duke ri-theksuar kushtet e rëna dakord për anëtarësim; duke theksuar përfitimet e zgjerimit për vendet anëtare aktuale dhe të ardhshme, dhe duke vënë në dukje nevojën për të komunikuar dhe për të shpjeguar procesin dhe objektivat e zgjerimit për publikun.<sup>7</sup>

Një shqetësim tjetër i vendeve të Ballkanit Perëndimor është dhe fakti që disa liderë evropianë në vend të alternativës së anëtarësimit kanë propozuar alternativën e "partneritetit të privilegjuar."<sup>8</sup> Megjithatë në këtë rast Komisioni është shprehur kundër kësaj alternative duke e konsideruar të papërshtatshme për rajonin e Ballkanit, ndonëse mbetet ende një variant i përfolur për Turqinë. Me të drejtë në këto kushte mund të pyesim "A ka ndryshuar parimi i kushtëzimit politik të anëtarësimit në BE pas zgjerimit të 2004 dhe manifestimit të dukshëm të "lodhjes nga zgjerimit" dhe pengesave të brendshme, përkundrejt vendeve jo-anëtare në pritje për anëtarësim. Sigurisht këto çështje meritojnë një diskutim me vete, por nuk janë objekt i këtij punimi. Sidoqoftë evidentimi i tyre vlen qoftë edhe për të vënë në dukje kompleksitetin e sfidave të integritimit për vendet e rajonit. Ndonëse sfidat e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të shumta duket se integrimi dhe siguria rajonale dhe progresi individual i secilit vend në drejtim të përmbushjes së kritereve të integritimit janë jo vetëm një kushtëzim i Bashkimit Evropian për anëtarësim, por dhe një domosdoshmëri për vetë sigurinë dhe zhvillimin e vetë vendeve të rajonit dhe këtu ja vlen të ndalemi për të bërë një analizë më të hollësishme, për të kuptuar më mirë sfidat dhe perspektivat e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian .

### **Ballkani dhe, sot dhe nesër**

Me fundin e Luftës së Ftohtë, Ballkani Perëndimor u përball me dy probleme serioze, që duket se edhe sot rëndojnë perspektivën e tij evropiane. Problemi i parë ka të bëjë me ringjalljen e nacionalizmit etnik, i cili filloi të lulëzojë kryesisht në Federatën Jugosllave, me fillimin e proceseve të modernizimit nëpërmjet politikave të ashtuquajtura të vetadministrimit jugosllav në fillim të viteve 1980, i cili u pasua me një krizë të rëndë ekonomike. Modernizimi dhe reformat në këtë kuadër synonin: decentralizimin e ekonomisë, ndryshimin e kulturës politike

me qëllim futjen e pluralizmit në jetën politike, orientimin e vlerave të shoqërisë në drejtim të respektimit të lirisë së individit e zgjedhjeve të tij, dhe emancipimin e shoqërisë dhe të traditës ushtarake. Por reformat demokratike në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare brenda republikave të Federatës Jugosllave, të organizuar me kushtetutën e 1974 rreth etnisë kryesore, duket se frymëzuan atë që Hajdeni do ta quante “nacionalizmi kushtetues,” që inkurajoi ndjenjat separatiste në mes të grupeve të ndryshme etnike në kërkim të një standardi më të mirë jetese.<sup>9</sup> Këto zhvillime prodhuan agresivitet e konflikt duke krijuar rrezik të madh për sigurinë dhe stabilitetin e republikave jugosllave ekzistuese, por edhe shteteve të tjera të rajonit, për shkak të efektit domino.

Luftërat që pasuan deri në fund të shekullit të njëzetë shkatërruan rajonin, ndërsa implikimet e tyre duket se rëndojnë ende në perspektivën evropiane të rajonit.<sup>10</sup> Siguria dhe kufijtë shtetërorë janë çështje ende në diskutim midis vendeve të rajonit. Jo më larg se viti 2008 kemi edhe krijimin e shtetit më të ri në rajon, Kosovës, pavarësia e së cilës ende është në rrugën e njohjes së plotë në nivel ndërkombëtar dhe kontestimet ende vazhdojnë edhe pse vlefshmëria e saj u miratua nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës, në korrik të vitit 2010. Mungesa e stabilitetit të kufijve dhe sigurisë sigurisht nuk favorizon jo vetëm integrimin rajonal, por përbën edhe një sfidë të madhe për anëtarësimin në BE. BE duket e vendosur të mos importojë brenda saj një konflikt tjetër si ai i Qipros, ku 7 vjet pas anëtarësimit të Qipros greke, ishulli vazhdon të mbetet i ndarë. Zhvillimet e fundit në Mesdhe në lidhje me të drejtën e përdorimit të pllajës kontinentale për kërkime të naftës dhe gazit po instalon një krizë të re midis të dy Qiprove dhe Greqisë dhe Turqisë mbrapa tyre,<sup>11</sup> që ka gjasa të importohet edhe në BE dhe implikimet e saj të ndikojnë politikat e saj të zgjerimit.<sup>12</sup>

Problemi i dytë, lidhet me stabilitetin e brendshëm politik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që mbetet thellësisht i polarizuar me aftësi të limituar kompromisi që shpjegohet kryesisht me legjitimitetin e udhëheqjes politike. E kaluara ka treguar se legjitimiteti në Ballkan është bazuar kryesisht në personalitetin e liderit karizmatik dhe të

9 Robert M. Hayden (Nov., 1996) “Imagined Communities and Real Victims: Self-Determination and Ethnic Cleansing in Yugoslavia” *American Ethnologist* 23(4): 783-801.

10 F. Stephen Larrabee and Robert Blackwill (1994) *The Volatile Powder Keg: Balkan Security After the Cold War*, Washington, D.C.: American University Press.

11 <http://www.euronews.net/2011/09/19/row-between-cyprus-and-turkey-over-offshore-drilling-escalates>

gjithëpushtetshëm.<sup>13</sup> Duket se një trashëgimi e tillë është mbartur edhe në kohën tonë mjaftojmë të sjellim në vëmendje udhëheqjen e pas Luftës së Dytë Botërore apo pas Luftës së Ftohtë në Ballkan, ku spikasin Tito, Hoxha, Milosheviçi, Tuxhmani apo Izedbegoviçi. Nga njëra anë, kjo trashëgimi ka instaluar autoritarizmin si mënyrë të qeverisjes së vendit. Nga ana tjetër, lidhja midis problemeve ekonomike dhe etnike dhe fuqizimit të liderit karizmatik kanë ndikuar dhunshëm dhe negativisht në legjitimitetin e regjimeve dhe zhvillimin e proceseve të demokratizimit në rajon. Shembulli më i dukshëm është Serbia e Milosheviçit.

Nuk ka asnjë dyshim se dekada e fundit e shekullit të njëzetë ka qenë jashtëzakonisht e vështirë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Armiqësitë dhe kultivimi i viktimizimit krijuan një mozaik shtet-kombesh të polarizuara në armiqësi. Në shumicën e vendeve, lufta, mungesa e konsensusit për reformat, përvoja e pakët në qeverisjen demokratike dhe institucionet e dobëta penguan progresin politik dhe ekonomik. Vonesat dhe pengesat e krijuara në zbatimin e programeve dhe reformave bënë që vendet e Ballkanit Perëndimor të devijojnë nga rruga e zhvillimit të ekonomisë së tregut e shoqëruar kjo me një rezultate të dobëta ekonomike, rënie të standardeve të jetesës, rritje të papunësisë dhe rritje të varfërisë. Këto zhvillime dhe referencat në të kaluarën përforcuan imazhin e një rajoni që nuk i përket një kontinenti tashmë me një zhvillim të qëndrueshëm, paqësor dhe të begatë. Zhvillimet e fundshekullit të kaluar, që në një masë të madhe duket se janë ende të pazgjidhura, po t'i referohemi shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe tensioneve që vazhdojnë të shoqërojnë njohjen e plote dhe çështjen e stabilitetit të kufijve të saj, kanë krijuar përshtypja se "Ballkani Perëndimor" dhe "integrimin evropian", janë dy qenësi të papërputhsme pasi u vu seriozisht në dyshim kapaciteti evropianizues i vendeve të rajonit.<sup>14</sup> Megjithatë, politika e integritit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor është përgjigja që do të lidhë vendet e rajonit me vlerat perëndimore. Perspektiva e integritit dhe adaptimi nga ana e BE-së e një politike kushtëzimi pozitiv pritet të ofrojë kornizën e nevojshme për demokracitë e reja për zhvillim dhe siguri të qëndrueshme.<sup>15</sup>

13 Sugar, Peter F., (1977) *Southeastern Europe under Ottoman Rule. 1354-1804*, University of Washington Press, Seattle, WA.

14 L. Demetropoulou, "Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and Europeanization Capacity in South Eastern Europe", *Southeast European Politics*, III (2-3), 2002.

15 O. Anastasakis & D. Bechev, "EU Conditionality in South-East Europe: Bringing Commitment to the Process", *European Balkan Observer* 1 (2), 2003; 46. C. Pippan, "The Rocky Road to Europe: The EU's Stabilisation and Association Process for the Western Balkans and the

## Bashkimi Evropian dhe integrimi i Ballkanit Perëndimor

Strategjia kryesore e zgjerimit të BE-së, që në fillim është bazuar në politikën e kushtëzimit. Në vitin 1993, Këshilli Evropian i mbledhur në Kopenhagen, propozoi Kriteret e Kopenhagenit, plotësimi me sukses i të cilave do të përcaktonte dhe nivelin e suksesit në drejtim të integritimit për të gjitha vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE. Kriteret synojnë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave, ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si dhe kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian; si dhe aftësimin për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë realizimin e qëllimeve të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.<sup>16</sup> Në vitin 1995, Këshilli Evropian i Madridit shtoi dhe dy kushte të tjera: rregullimin e strukturave administrative dhe transpozimin e legjislacionit të BE-së në legjislacionin kombëtar.<sup>17</sup>

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme të cilat përcaktojnë dhe vlerësojnë meritat individuale të vendeve kandidate në raport me to, BE-ja ofron “qasjen rajonale”, me kushte politike dhe ekonomike për Ballkanin Perëndimor si bazë për një politikë koherente dhe transparente në drejtim të zhvillimit të marrëdhënieve në fushën e tregtisë, ndihmës financiare dhe bashkëpunimit ekonomik, si dhe marrëdhënieve kontraktore, duke lejuar një shkallë të nevojshme të fleksibilitetit.<sup>18</sup> Kjo strategji e BE-së është menduar të shërbejë si një nxitje, dhe jo një pengesë, për vendet që aspirojnë anëtarësimin. Integrimi rajonal përbën një proces të nevojshëm pasi inkurajon paqe dhe stabilitet në rajon, nëpërmjet inkurajimit të pajtimit, të fqinjësisë së mirë dhe marrëdhënieve të mira politike, jep një ndihmë në tejkalimin e nacionalizmit dhe të tolerancës dhe promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të dialogut politik në rajon. Një trajtim i tillë u pa i dobishëm të institucionalizohet sidomos pas përfundimit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Për këtë qëllim u krijua Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, që kishte për qëllim krijimin dhe forcimin e paqes dhe sigurisë në Evropën Juglindore, me qëllim rivendosjen e stabilitetit dhe parandalimin e konfliktit. Ai kryesisht u

16 Op cit. note 2.

17 Madrid European Council (12/95). Conclusions. [www.europarl.europa.eu/summits/mad1\\_en.htm](http://www.europarl.europa.eu/summits/mad1_en.htm)

18 Regional Approach, (1997), [http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement\\_process/accesion\\_process/how\\_does\\_a\\_country\\_join\\_the\\_eu/sap/history\\_en.htm#regional\\_dimension](http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accesion_process/how_does_a_country_join_the_eu/sap/history_en.htm#regional_dimension).



fokusua në çështjet e demokratizimit, respektimit të të drejtave të njeriut, rindërtimit ekonomik, bashkëpunimit dhe zhvillimit, dhe të sigurisë. Pakti i Stabilitetit u krijua në vitin 1999 me iniciativën e Bashkimit Evropian dhe përfshin vende dhe organizata ndërkombëtare si partnerë. Pakti i Stabilitetit kishte për qëllim angazhimet e përbashkëta për të nxitur stabilitetin dhe rritjen ekonomike.<sup>19</sup> Qasja rajonale ndonëse nuk është braktisur, duket se u plotësua me një qasje më të specializuar për secilin vend të rajonit sikundër veçantitë e problemeve të secilit nuk janë të shpërfillura dhe duket se nuk mund të zgjidhen në grup.

Kështu, në maj 1999, Bashkimi Evropian propozoi dhe adaptoi Procesin e Stabilizim Asociimit (PSA) për secilin nga pesë vendet e Ballkanit Perëndimor. Një propozim që u mirëprit nga vendet e rajonit në Samitin e Zagrebit, në nëntor të vitit 2000.<sup>20</sup> Kjo ishte një përpjekje e re për të tërhequr rajonin në perspektivën evropiane. Duke marrë parasysh përvojën e Evropës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore, në kapërcimin e pasojave të luftës dhe të politikave nacionaliste të shteteve nëpërmjet bashkëpunimit dhe integritit gradual të ekonomisë, BE miratoi PSA-në jo vetëm si një instrument për të mbështetur përpjekjet e vendeve për rindërtimin ekonomik të tyre dhe të reformimit të sistemit të tyre politik me qëllim arritjen e standardeve të kërkuara, por edhe për të shprehur gatishmërinë e saj për të pranuar këto vende si kandidatë të mundshëm për anëtarësim. PSA është korniza kryesore e politikave, për marrëdhëniet e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), sistemi i preferencave tregtare dhe asistencë teknike dhe financiare janë tre instrumentet kryesore i shërbejnë stabilizimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'i sjellë gradualisht ato në përputhje me sistemin ekonomik dhe juridik të BE-së. Politika e BE-së në nivelin dypalësh, rajonal dhe multilaterale janë komplementare në kuadër të PSA-së.

Deri në Samitin e Selanikut, BE-ja ka promovuar një qasje që synonte mbajtjen e Ballkanit Perëndimor në Evropë, por jashtë strukturave të BE-së. Bashkëpunimi rajonal është promovuar si një alternativë që mund të sjellë minimalisht stabilitetin e nevojshëm për lehtësimin e tregtisë dhe më gjerë në krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e demokracisë, ekonomisë së tregut dhe marrëdhënieve normale, duke hapur kështu rrugën për prosperitet ekonomik. Në këtë kontekst, praktika e transformimit

19 <http://www.stabilitypact.org/e-see>.

20 [http://ec.europa.eu/external\\_relations/balkans/](http://ec.europa.eu/external_relations/balkans/)

përpara pranimit që karakterizon zgjerimit drejt lindjes, evropianizimi rajonit, sipas modelit normativ të BE-se është bërë një domosdoshmëri. Ndonëse entuziazmi fillestar për një anëtarësim të mundshëm në BE është shoqëruar me zhgënjim dhe frustrim, oferta e dyfishtë e institucionalizimit dhe anëtarësimit të plotë është bërë një nxitës i fortë për të mbajtur vendet e Ballkanit Perëndimor në orbitën e BE-së.

Samiti i Selanikut, në qershor 2003, ofroi ndihmë për të rritur bashkëpunimin rajonal dhe forcuar procesit e stabilizimit dhe integritit të Ballkanin Perëndimor. "E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin Evropian" ishte pjesë e deklaratës së samitit. Deklarata bëri të qartë për të parën herë perspektivën evropiane të rajonit, por që e ardhmja mbetet në duart e vendeve ballkanase, që me veprimet e tyre konkrete drejt rrugës së evropianizimit ekonomik, politik, social, do të mund të aspirojnë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.<sup>21</sup> Në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, inkurajohet tregtia e lirë në nivel rajonal, krijimi i tregjeve rajonale për energji elektrike dhe gaz, zhvillimi i energjetikës, transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës, mbrojtjes së mjedisit, teknologjisë së kërkimit dhe zhvillimit, bashkëpunimit ndërkuftar dhe parlamentar.

Një sipërmarrje e tillë sigurisht është shoqëruar me edhe me mbështetje financiare për reformat dhe zhvillimin ekonomik, infrastrukturor, etj. të vendeve të Ballkanit. BE-ja është donatori më i madh për Ballkanin Perëndimor. Kështu, që nga viti 1991, BE-ja ka dhënë mbi 7 miliardë euro për të ndihmuar rindërtimin e infrastrukturës dhe për të promovuar demokracinë, zhvillimin ekonomik dhe social dhe bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Për të mbështetur procesin e PAS-së, u krijua Programi CARDS (2000-2006)<sup>22</sup>, duke zëvendësuar PHARE<sup>23</sup>, me një zarf financiar prej 5.13 miliardë euro për mbështetjen në ndërtimin e institucioneve, drejtësisë dhe sigurisë së brendshme, bashkëpunimit ndërkuftar, të sektorit privat dhe zhvillimin e infrastrukturës, përmirësimin e procesit të integritit të rajonit.<sup>24</sup>

Interesat e Bashkimin Evropian janë për të përforcuar marrëdhëniet e saj me fqinjët në të gjitha fushat, në veçanti me vendet që aspirojnë të

21 Op. Cit. Note 2.

22 [http://europa.eu/legislation\\_summaries/enlargement/western\\_balkans/r18002\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/r18002_en.htm).

23 European Commission, The Report on the Evaluation of PHARE Partnership Programme, DGIA, December 1998.

24 [http://ec.europa.eu/enlargement/how\\_does\\_it\\_work/financial\\_assistance/cards/](http://ec.europa.eu/enlargement/how_does_it_work/financial_assistance/cards/)

anëtarësohen. Kapaciteti i Bashkimit për të garantuar për qytetarët e saj, stabilitet e siguri dhe zhvillimi të qëndrueshëm është i lidhur ngushtësisht me bashkëpunimin dhe sigurinë e fqinjët e saj më të afërt. Prandaj, në interes të politikës dhe të sigurisë së saj, BE-ja nuk mund të lërë pas dore Ballkanin Perëndimor. Luftërat e fundit dhe konfliktet në Ballkanin Perëndimor kanë ngjallur në mendjet e evropianëve Ballkanin si “fuçi baruti” të kontinentit. Për shkak të afërsisë gjeografike, siguria e Ballkanit Perëndimor është një çështje e rëndësishme për sigurinë e BE-së në tërësi, dhe për disa shtete të veçanta të Bashkimit në mënyrë drejtpërdrejtë. Në ditët e sotme, nuk ekziston frika e pushtimit që vjen nga jugu, shqetësimi kryesor ka të bëjë me «pushtimin» nga refugjatët ekonomikë. Kjo çështje është bërë një sfidë për kohezionin social të Bashkimit dhe është konsideruar si një çështje me pasoja e implikime në sigurinë e tij.

Për më tepër braktisja e Ballkanit Perëndimor do të krijojë një ndarje në Evropë në mes të vendeve të begata dhe të varfra. Balanca ekzistuese në BE mund të shkatërrohet, duke rritur armiqësitë brenda Evropës dhe duke vënë seriozisht në vështirësi vazhdimin e projektit evropian. BE-ja është përqendruar në politikat e kohezionit, që synon adresimin e çështjeve të disbalancave strukturore ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim parandalimin e krijimit të linjave të reja ndarëse brenda rajonit dhe për të forcuar procesin e reformave dhe kapaciteteve qeverisëse në rajon. Politika e kohezionit, në kuadrin e PAS-së është zgjeruar duke përfshirë edhe forma të tjera të parapranimit. Përveç përmirësimit të rezultateve të reformave këto politika dërgojnë sinjale të fortë në vendet e Ballkanit Perëndimor që BE-ja është e angazhuar seriozisht për të ndihmuar integrimin e tyre në BE. Kështu në 2007-tën, për të ndihmuar individualisht dhe në mënyrë konkrete secilin prej vendeve aspirantë për anëtarësim u adaptuan Instrumentet e Para-aderimit (IPA) për Ballkanin Perëndimor. IPA ofron ndihmë në procesin e tranzicionit dhe ndërtimit të institucioneve së bashku me nxitjen e bashkëpunimit ndërkuftar, qëndrueshmërinë e burimeve rajonale dhe njerëzore dhe zhvillimin rural.

Marrëveshja për anëtarësim e ofruar nga BE-se Serbisë në mars 2012, është një demonstrim i fortë i angazhimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Së fundi Kosova është angazhimi më i ri i Bashkimit Evropian. BE mbështet zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës. Komisioni është shprehur se perspektiva e Kosovës është në Bashkimin Evropian ashtu si pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor dhe BE-ja do të ndihmojë me instrumentet e nevojshme për promovimin e reformave demokratike,

i rëndësishëm në këtë drejtim mund të quhet edhe njohja e shtetit të Kosovës nga pothuajse 2/3 e shteteve anëtare të Bashkimit Europian si dhe asistenca që jepet nga misioni EULEX në këtë drejtim.

Në nivel rajonal, që në vitin 2001, BE-ja inkurajoi nënshkrimin e një «Memorandumi të Mirëkuptimit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Liberalizimit» në mes të vendeve të rajonit, duke përfshirë Rumaninë dhe Bullgarinë, si dhe Moldavinë nën patronazhin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Në këtë Memorandum, vendet e përfshira u angazhuan për të përfunduar para fundit të vitit 2002, një rrjet të marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë. Ky rrjet i më shumë se 30 marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë është transformuar në fund të vitit 2006 në një marrëveshje të tregtisë rajonale të quajtur CEFTA. Marrëveshja e CEFTA-s u nënshkrua më 19 dhjetor 2006 në Bukuresht (nga të gjithë vendet e Ballkanit dhe Moldavia) dhe hyri në fuqi në mes të 2007. Edhe pse nuk është palë në CEFTA, BE-ja ka mbështetur fuqimisht këtë proces, të cilin e sheh si shumë plotësuese të SAP-it. Krijimi i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), më 27 shkurt 2008, në Sofje, në anën tjetër, shënoi kalimin formal nga Pakti i Stabilitetit në RCC. Kalimi nga Pakti i Stabilitetit në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBP) është arritja më e madhe e momentit, pasi synon ndërgjegjësimin e vendeve të rajonit për marrjen përsipër të procesit të bashkëpunimit dhe kooperimit rajonal. Krijimi i RCC-së perceptohet si dëshmi e progresit substancial në bashkëpunimin rajonal për çështjet e demokracisë, ekonomisë dhe të sigurisë.<sup>25</sup> BE mbështet këtë strukturë dhe bashkëpunime të ngjashme me të siç janë CEFTA, Traktati Komunitar për Energjinë dhe Marrëveshja mbi një Zonë të Përbashkët Evropiane për Aviacionin. Gjithashtu, është propozuar të bëhen negociata për një Traktat Komunitar për Transportin në Ballkanin Perëndimor.

Megjithatë, rritja e efektivitetit të politikave të BE-së lidhet ngushtë me inkurajimin e proceseve dhe mekanizmave të evropianizimit në rajon. Kjo do të kërkonte për së pari, që BE-ja vetë të procedojë me shpejtësi në adoptimin e reformave të brendshme me qëllim thellimin e integritetit tashmë një domosdoshmëri e nevojshme për mbrojtjen e projektit evropian. Së dyti, për arritjen e konsensusit dhe mirëkuptimit në rajon BE-ja duhet të gjenerojë më shumë kontakte mes grupeve të ndryshme të interesit brenda Ballkanit me ato të vendeve të BE-së, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në një shumëllojshmëri programesh e shkëmbimesh, komitetesh dhe takimesh, me qëllim krijimin e rrjeteve të

bashkëpunimit që do të lehtësojë të mësuarit dhe adaptimin e nevojshëm për anëtarësimin e ardhshëm. Në lidhje me kontrollin, BE-ja duhet të mbajë një prani të fortë ndërkombëtare dhe të krijojë mekanizmat dhe mjete të nevojshme të përshtatshme për monitorim. Së fundi, në lidhje me kushtëzimet, BE-ja duhet të vendosë kushte reale që mund të përmbushen, lidhja e tyre me anëtarësimin të jetë e dukshme dhe tu lejojnë vendet të vazhdojnë anëtarësimin e tyre pa u bllokuar nga vonesat e të tjerëve. BE-ja duhet të ofrojë mbështetje për Ballkanin Perëndimor për të eliminuar konfliktet midis proceseve dhe të krijojë një bazë më të qëndrueshme për konvergjencë dhe akomodim. Në anën tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të rrisin bashkëpunimin e brendshëm për hir të interesit të tyre të përbashkët – si pjesë e familjes së madhe evropiane.

### Shqipëria dhe treni Evropë

E ardhmja e Shqipërisë është e lidhur me integrimin e saj në institucionet euro-atlantike. Nga njëra anë Shqipëria ndan prejardhje të përbashkët dhe gjuhë me vendet e tjera të Kontinentit Evropian. Në të njëjtën kohë, Shqipëria është një vend ballkanik, që ndan historinë dhe fatin e saj me vendet e tjera të rajonit. Ndarjet e mëdha në Evropë dhe kalimi i qytetërimeve të ndryshme të gjitha u jetuan në Ballkan duke bërë historinë e tij. Shqiptarët janë përplasur me këto qytetërime si shumica e vendeve të Ballkanit. Shqipëria ka qenë pjesë e Perandorisë Romake dhe pas skizmës së kishës së krishterë midis Lindjes dhe Perëndimit, ajo mbeti pjesë e Perandorisë Bizantine, për të qenë më vonë pjesë e Perandorisë Osmane dhe më pas pjesë e Bllokut Socialist.

Të gjitha këto ngjarje kanë ndikuar në identitetin e shqiptarëve dhe sot “Shqipëria, si shumica e shteteve të Ballkanit, është ende e papërgatitur për lirinë evropiane.”<sup>26</sup> Megjithatë, siç shkruan Ismail Kadare, “Gjergj Kastrioti, së bashku me rebelimin e tij të bujshme kundër perandorisë otomane solli një ideal të ri: ndarjen nga Lindja, aleancë me Perëndimin.”<sup>27</sup> Shqiptarët kanë vendosur të jetë pjesë e ‘lirisë evropiane’, dhe nuk ka dyshim mbi identitetin e tyre evropian. “Liria shqiptare është zhvillim normal dhe i natyrshëm i shqiptarëve në harmoni me frymën e Evropës së Bashkuar. Gjetja e mënyrave për të lejuar këtë zhvillim, e ndërprerë për fat të keq, është në fakt zgjidhja e vetme për problemin kardinal të

26 Ismail Kadare, “Në Kërkim të Një Fati të Ri”, Forum: Shqiptarët në Ballkan, Tiranë, 2001, p. 19.

shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit.”<sup>28</sup> Mënyra për këtë zhvillim të dëshiruar është integritet në BE. Procesi i integritet premt për stabilizim dhe rindërtim, si dhe zhvillim të qëndrueshëm, dhe kohezion ekonomik dhe social me BE-në. Integritet nuk është vetëm një aspiratë politike e të gjitha partive politike shqiptare, ai është i mirëpritur dhe i dëshiruar nga mbi 95 për qind e shqiptarëve, siç tregojnë vëzhgimet e përvitshme të organizuara tashme që prej disa vjetësh nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare në Tiranë (AIIS).<sup>29</sup>

Që nga viti 1992, Shqipëria ndjek një politikë të qartë pro-perëndimore dhe ka për qëllim kryesorë përmirësimin e lidhjeve me BE-në. Kjo politikë vazhdimisht mbetet shqetësimi kryesor i të gjithë spektrit politik në Shqipëri. Kështu, të gjithë politikanët shqiptarë kanë përfshirë kërkesën për anëtarësim në BE si pjesë të platformës së tyre politike.<sup>30</sup> Në këtë këndvështrim “strategjia kryesore që Shqipëria ka miratuar për integritet në arenën botërore ka qenë ajo e orientimit të zhvillimeve të saj të brendshme dhe marrëdhënieve me jashtë në drejtim të BE-së.”<sup>31</sup>

Organizimi politik, ekonomik dhe trashëgimitë historike të cilat kanë ndikuar kryesisht mbi shqiptarët kanë përcaktuar tjetërsimin e tyre dhe distancimin nga familja e madhe evropiane për një kohë të gjatë. Kështu duke filluar nga viti 1978, Shqipëria instaloi një politikë të “despotizmit” dhe “autarkisë”. Sistemi ekonomik u vetë izoluar krejtësisht nga bota me një politikë çmimesh dhe pagash fikse, si dhe një standard shumë të ulët të jetesës. Në vitet 1990, tregtia përfaqësoje një përqindje mjaft të vogël të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), me eksportet dhe importet respektivisht 14 për qind dhe 22 për qind të PBB-së.<sup>32</sup> Në fillim të viteve 1990 Shqipëria konsiderohej një ekonomi relativisht e mbyllur dhe një eksportuese kryesisht e lëndëve të para të papërpunuara.

Në fund të viteve 1990, pozicioni i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare u përkeqësua, dhe tregtia u pakësua në mënyrë të konsiderueshme. Keqmenaxhimi ekonomik i vendit u shoqërua nga një thatësi e madhe dhe e stërzgjatur e cila e përkeqësoi situatën ekonomike

28 Cituar më sipër shënimi 25. fq 20.

29 Enika Abazi (2009) Integritet i Shqipërisë, Perceptime dhe Realitete, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë.

30 James Pettifer and Miranda Vickers, Albania: From Anarchy to a Balkan Identity, London, Hurst and Company, 1997.

31 Alish M. Johnson, “Albania’s Relations with the EU: On the Road to Europe,” Journal of Southern Europe and the Balkans Vol. 3, No. 2, 2001, pp. 171–192.

32 Ministria e Tregtisë dhe Marrëdhënieve Ekonomike me Jashtë. *Buletini Vjetor* (1999)

dhe sociale ne vend. Ka pasur edhe shumë faktorë të tjerë negative, të tilla si rënia e furnizimit të brendshëm shkaktuar nga problemet në prodhimin e brendshëm, reduktimi i eksporteve dhe rritja e importeve. Tregtia dhe eksportet drejt Evropës Lindore u ndërpreën. Kjo u reflektua në deficitin e lartë tregtar në monedhë jo-të konvertueshme që u thellua në vitin 1990. Gjatë periudhës 1988-1990, mungesa e kontrollit mbi menaxhimin e rezervave në monedhë të huaj solli humbje nga spekulime në këmbimin valutor që arrinin në 10 për qind të PBB-së. Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një deficit të lartë i cili u financua nëpërmjet ezaurimit të rezervave në monedhë të huaj, huamarrjes së jashtme, vonesës së pagesës së borxhit të tregtisë së jashtme, huamarrjes ndër-bankare, dhe spekulimeve nga transaksionet e këmbimit të huaj. Totali i borxhit të jashtëm, duke përfshirë edhe borxhin e lidhur me financimin e deficitit të llogarisë korente në monedhë jo-të konvertueshme, u rrit në rreth 500 milionë dollarë ose 30 për qind e PBB-së deri në qershor 1991<sup>33</sup>. Një situatë e tillë ekonomike u shoqërua me racionimin ushqimor të popullatës dhe shkurtimin e shumë përfitimeve të tjera. Të gjitha këto zhvillime tregojnë se starti nga filluan përpjekjet për integrim dhe zhvillim të shqiptarëve ishte shumë jo favorizues po të kemi parasysh standardet e Evropës ku tashmë inspirohej aderimi.

Duket se sfidat me të cilat është përballur Shqipëria në rrugën e integrimit në strukturat e BE-së kanë qenë të shumta dhe ende vazhdojnë të jenë të tilla me gjithë progresin e bërë. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash për transformimin e sistemit të centralizuar të ekonomisë dhe politikës në një ekonomi të decentralizuar të tregut me një shoqëri pluraliste që ofron mundësi të barabarta për të gjithë dhe një demokraci liberale të bazuar në të drejtat e njeriut, kushtetutshmëri dhe shtet ligjor. Qëllimi i këtyre transformimeve është i qartë: përmbushja e kërkesave të BE-së për një anëtarësim të ardhshëm. BE-ja ka mbështetur angazhimin e Shqipërisë në përmbushjen e parimeve të mësipërme nëpërmjet qasjes bilaterale dhe asaj saj rajonale në mënyrë të kombinuar.<sup>34</sup>

Akti i parë që hapi rrugën për bashkëpunim bilateral mes BE-së dhe Shqipërisë ka qenë "Marrëveshja mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik", në fuqi që nga dhjetori 1992, me një perspektivë për asociim në preambulën e saj. Megjithatë, kjo marrëveshje nuk kishte një natyrë preferenciale. Një deklaratë e përbashkët pas nënshkrimit të Marrëveshjes vijonte me bërjen të ditur të qëllimit të të dyja palëve që synonin instalimin

e dialogut politik midis palëve. Një marrëveshje për preferenca tregtare u nënshkruar më vonë me BE-në. Kjo marrëveshje ishte një zgjatim i "Marrëveshje mbi Tregtinë e prodhimeve të tekstilit" të 1993-shit. Marrëveshja ofronte hapësirë në tregun evropian për eksportet tekstile shqiptare, duke u bërë kështu mbështetje për zhvillimin e industrisë dhe të investimeve në industrinë e tekstilit.

Në kontekstin e qasjes rajonale, në vitin 1998, BE-ja u dha Shqipërisë dhe vendeve e tjera të Ballkanit Perëndimor tarifa asimetrike preferenciale me qëllim favorizimin e një bashkëpunimi më të ngushtë ekonomik me shtetet anëtare.<sup>35</sup> Marrëveshja ofronte tarifa preferenciale për importet nga Shqipëria për një periudhë trevjeçare.<sup>36</sup> Me qëllim rritjen e futjes të mallrave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, një marrëveshje tjetër u shtri edhe për Shqipërinë. Marrëveshja hiqte kuotat për disa produkte industriale që hynin në BE nga Shqipëria.<sup>37</sup> Në shtator 2000, Komisioni Evropian miratoi heqjen e taksave doganore për produktet industriale dhe tekstile shqiptare që hynin në tregun e BE-së.<sup>38</sup>

Kështu si rezultati i masave favorizuese që nga viti 2000 tregtia e Shqipërisë me BE-në ka pasur zhvillime të rëndësishme. Veçanërisht me dhënien e preferencave shtesë në kuadrin e Marrëveshjes së Ndërmjetme në dhjetor të 2006-ës, BE-ja rezulton të jetë bërë partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Kështu në vitin 2007 tregtia me BE-në përfaqësonte 74,5% të tregtisë totale të Shqipërisë. Ndërkohë që importet dhe eksportet janë rritur, duhet vënë në dukje se hendeku mes importeve dhe eksporteve është zgjerua duke sjellë rritjen e deficitit tregtar. Për më tepër një fakt i tillë vë në dukje jo vetëm mungesën e konkurrencës së produkteve shqiptare në tregun evropian, por edhe nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të vendit.

Pavarësia e Kosovës ofron për Shqipërinë një perspektivë të re për integrimin e saj në skemat rajonale dhe evropiane. Integrimi mbetet e vetmja zgjidhje e aftë për të t'i dhënë fund rivaliteteve të rajonit dhe armiqtësive historike. Integrimi i Shqipërisë në strukturat Euro-Atlantike konsiderohet si një element i rëndësishëm në kontekstin e stabilitetit për

35 EC Regulation No. 2820/1998.

36 Council of the European Union, European Community Council Regulation Concerning Agreements Applicable to

Albanian Imports into the EC and the Extension of Generalised Tariff Preferences 1 July 1999–31 December 2001, COM. (1999) 304 final, 18 June 1999.

37 European Commission, Commission Proposes Increased Market Access for Products from the Western Balkans, IP/00/586, 7 June, 2000.



Evropën Juglindore. Kështu, trojka evropiane do të deklaronte "Në mënyrë që të tërheqë Shqipërinë më afër këtij qëllimi, do të bëhet çdo përpjekje për përdorimin në mënyrë aktive të të gjitha instrumenteve ekzistuese të asistencës dhe bashkëpunimit, duke shqyrtuar të gjitha mundësitë e rritjes së mëtejshme."<sup>39</sup> Fillimisht ofrimi i MSA-së, një marrëveshje e ofruar veçanërisht për vendet e Ballkanit Perëndimor, e propozuar edhe për Shqipërinë, nxori në pah synimin e BE-së për ta «tërhequr rajonin më pranë perspektivës së integritit të plotë në strukturat e BE-së».<sup>40</sup>

Objektivi i MSA është të mbështesë konsolidimin e demokracisë, sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal. Marrëveshja synon krijimin e një zone të tregtisë së lirë mes BE-së dhe secilit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor. MSA do të kontribuojë në objektivat e BE-së në tri mënyra: Duke sjellë vendet e rajonit më afër standardeve, të cilat zbatohen në BE; duke krijuar kushte për respektimin e parimeve kryesore demokratike si të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, krijimin e institucioneve të qëndrueshme demokratike, etj; duke zhvilluar elementet kryesore, të cilat janë në zemër të tregut të BE-së, në lidhje me konkurrencën dhe ndihmat shtetërore, të drejtat e pronësisë intelektuale, etj.

Negociatat për procesin e stabilizim-asociimit të Shqipërisë për anëtarësim në BE, të filluara më 31 janar 2003 u finalizuan me nënshkrimin e MSA-së, më 12 qershor 2006. Marrëveshja hyri në fuqi pas ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare në vitin 2008. Ndërsa në dhjetor të vitit 2010 u materializua edhe liberalizimi i vizave për në BE për të gjithë shqiptarët. Pas fitimit të statusit të vendit kandidat, ndoshta në tetor 2012, pritet dhe fillimi i negociatave për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në BE, duke i lejuar vendit të arrijë përparimin e fqinjëve, që me përjashtim të Bosnjë Hercegovinës dhe Kosovës, i kanë hapur negociatat për anëtarësim.

Përveç marrëveshjeve të ndryshme të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, ekziston edhe një ndihmë ekonomike dhe financiare e zgjeruar në formën e ndihmave, asistencës dhe granteve. Qëllimi i kësaj ndihme është të për të ndihmuar tranzicionin e Shqipërisë dhe procesin e kohezionin me standardet e BE-së. Ndihma financiare dhe teknike e BE-së përkundrejt Shqipërisë mund të ndahet në tre periudha kryesore. Faza e parë zgjat nga viti 1991 deri në vitin 1997; faza e dytë, prej vitit 1997 deri 1999, kur BE-ja vendosi të zhvillojë procesin e Stabilizim Asociimit

39 "Joint Statement following the Political Dialogue Meeting at Ministerial Level Between the European Union Troika and Albania", Press/99/121, Luxembourg, 27 April 1999.

për Ballkanin Perëndimor, dhe faza finale, nga 2001 në vijim, kur BE-ja filloi Programin CARDS të asistencës për Ballkanin Perëndimor, që më vonë u pasua nga ai i instrumenteve të para anëtarësimit (IPA) me qëllim finalizimin e anëtarësimit të plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor përfshi edhe Shqipërinë në BE.<sup>41</sup>

Mbështetja ekonomike dhe financiare e BE-së për Shqipërinë filloi në vitin 1991, me përfshirjen në Programin PHARE<sup>42</sup>. Periudha e parë e financimit i korrespondon fillimit të proceseve demokratike në vend dhe PHARE përbënte një instrument të rëndësishëm të ndihmës së BE-së që do të shërbente për të "promovuar zhvillimin social-ekonomik dhe për të mbështetur procesin e reformave në Vendet e Evropës Qendrore, si dhe për të rritur efektivitetin e procesit të bashkëpunimit, dhe për të nxitur partneritetin e BE-së me këto vende."<sup>43</sup> PHARE asistoi vendet e Europës Lindore dhe Juglindore financiarisht duke mbështetur nëpërmjet një sërë instrumentesh të ndryshme procesin e reformave në vende jo-kandidate si Shqipëria.

Në mbështetje të zhvillimit të shoqërisë civile programi PHARE zhvilloi idenë e Programit të Partneritetit të PHARE (PPP). Ideja prapa këtij programi ishte zhvillimi i shoqërisë civile në vendet ish-komuniste, si një pjesë e rëndësishme e konsolidimit të demokracisë. Brenda këtij kuadri, fuqizimi i ndikimit të qytetarëve në jetën politike të vendit, në procesin e vendimmarrjes dhe në përgjithësi në kushtet në të cilat ata jetojnë, është konsideruar një hap i rëndësishëm drejt një kulture politike demokratike të konsoliduar. Në këtë drejtim zhvillimi i Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) është konsideruar si një tregues thelbësor me një kontribut të rëndësishëm për krijimin e një kulture politike demokratike. PPP ka shërbyer edhe për të ndihmuar në ndërtimin e partneriteteve midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit dhe krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit në mes të OJQ-ve, parë kjo si një mekanizëm i rëndësishëm për transferimin e njohurive dhe përvojës së BE-së në ndihmë të procesit të reformave dhe integritit. Filozofia mbrapa kësaj ndihme financiare dhe teknike

41 Hoffmann, Judith. 2005. Integrating Albania: the Role of the European Union in the Democratization Process. *Albanian Journal of Politics*, 1 (1): 55-74.

42 PHARE, ishte fillimisht një program i ndihmës për Rindërtim e Ekonomisë së Polonisë dhe Hungarisë, më vonë ajo u shtri edhe për vendet e tjera të Europës Lindore e Qendrore, në fakt, 14 ishte numri i vendeve të përfshira nën këtë program: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia dhe Kroacia.

është ndërtimi i legjitimitetit dhe mbështetjes morale për reformat dhe vendimmarrjen politike si dhe inkurajimin e proceseve të mësimi nga përvojave perëndimore për çështje të ndryshme. Programi Tempus, të cilit Shqipëria ju bashkua në vitin 1992, është një tjetër formë e ndihmës financiare që mbështet sistemin arsimor dhe favorizon përmirësimin e punës akademike të akademikëve shqiptarë dhe studentëve.

Midis 1991 dhe 1997, Shqipëria mori 450.6 milion ECU mbështetje nga PHARE, duke përfshirë edhe 130.3 milion ECU për zhvillimin e infrastrukturës dhe 74.5 milion ECU në ndihma të emergjencës. Burimet e PHARE ishin kanalizuar në katër fusha kryesore: administratën publike dhe reformat institucionale, zhvillimin e komunitetit, zhvillimin e infrastrukturës në shkallë të gjerë, dhe zhvillimin e bujqësisë. Vetëm në vitin 1997, PHARE ka ofruar 34 milionë ECU për programet kombëtare dhe 20 milionë ECU për programet ndërkufitare të bashkëpunimit. Përveç kësaj, ndihmë e veçantë me vlerë 14.9 milion ECU është dhënë në mbështetje të buxhetit dhe për reformën në administratën publike. Mbështetje i është dhënë edhe OSBE-së për organizimin e zgjedhjeve në qershor-korrik 1997, në shumën 1.5 milion ECU.<sup>44</sup>

Gjatë krizës së vitit 1997 në Shqipëri, të shkaktuar nga kolapsi i skemave piramidale të investimeve, mbështetja e programit PHARE u ndërpre. Megjithatë, ndihma humanitare vazhdoi nëpërmjet Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme të Ndhmës Humanitare (DG ECHO), me qëllim mbulimin e nevojave më urgjente të pjesës më të varfër të popullsisë. Këtu fillon edhe faza e dyte e kontributit financiar të BE-së. Kjo ndihmë arriti në 17 milion ECU dhe përbëhej nga ushqime dhe furnizime mjekësore. Komisioni Evropian gjithashtu ka vazhduar të financojë disa aktivitete me qëllim promovimin e demokracisë, sigurisë dhe stabilitetit ekonomik, duke përfshirë këtu edhe mbështetjen për OSBE-në për organizimin e zgjedhjeve.

Në vitin 2000 Komisioni Evropian, për të thjeshtuar dhe përsheptuar ndihmën për vendet e Ballkanit Perëndimor, propozoi programin CARDS i cili ofronte një format ligjor të unifikuar dhe një set të vetëm të procedurave për asistencën e ofruar vendeve të Ballkanit. Në këtë proces vendet përfituese (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi), do të duhet të orientojnë zhvillimin e tyre politik, ekonomik dhe institucional në përputhje me vlerat dhe modelet e Bashkimit Evropian.<sup>45</sup>

44 Këshilli i Ministrave të Shqipërisë: Departamenti i Zhvillimit dhe Koordinimit të

Kjo përbën dhe fazën e tretë të kontributit të BE-së ndaj vendeve të rajonit dhe Shqipërisë. Shqipëria filloi të marrë fonde sipas rregullores CARDS në vitin 2001. Programi CARDS u fokusua kryesisht në mbështetjen e objektivave dhe mekanizmave të Procesit të Stabilizim Asocimit në kuadrin e avancimit të procesit të integritimit. Asistenca u fokusua kryesisht në mbështetjen e reformave dhe procesit të ndërtimit të institucioneve. Në kontrast me periudhat e mëparshme programi i ndihmës për periudhën 2002-2004, synonte mbështetjen për sektorë të tillë si drejtësia, demokratizimit dhe administrata publike. Asistenca në periudhën 2002-2004 nga programi CARDS arriti në 143 milionë euro.<sup>46</sup>

Instrumentet e Para-Anëtarësimit (IPA) zëvendësuan CARDS me një qëllim të qartë anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshi edhe Shqipërinë në BE. IPA është i përbërë nga pesë komponentë që ofrojnë ndihmë të specializuar dhe efektive sipas nevojave të Shqipërisë dhe zhvillimeve konkrete. Vetëm për periudhën 2007-2009 ndihma e para-anëtarësimit në bazë të kornizës institucionale shumë-vjeçare të financimit për Shqipërinë ka qenë 221,9 milion €. Ndërsa që nga viti 2007 deri në 2012, ndihma financiare e alokuar nga BE në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA) për Shqipërinë është 498 milion euro me qëllimin ndërtimin e institucioneve dhe kryerjen e transformimeve dhe për arritjen e standardeve të kërkuara si dhe bashkëpunimit ndër kufitar.<sup>47</sup>

Nga një shqyrtim i hollësishëm i asistencës dhe ndihmës financiare së BE gjatë këtyre tre fazave mund të vihet re dhe ndryshimi i natyrës dhe qëllimit të saj në kohë. Kështu për periudhën 1996-1999 fokusi kryesor i asistencës ishte në zhvillimin e infrastrukturës me rreth 60 për qind të fondeve, pra një qasje kryesisht në mbështetje të zhvillimit dhe rindërtimit ekonomik. Ndërsa gjatë periudhës 2002-2004 e në vijim kemi një zhvendosje në drejtim të mbështetjes së reformës në administratën publike (duke përfshirë edhe reformën e gjyqësorit) ku kane shkuar 60 për qind e ndihmës së ofruar, me qëllim mbështetjen e procesit të integritimit të plote të Shqipërisë në BE.<sup>48</sup>

Me gjithë progresin e bërë në drejtim të anëtarësim të plotë në BE,

---

the Western Balkans, (IP/00/456) Brussels, 10 May 2000.

46 European Commission. 2001. Albania Country Strategy Paper 2002-2006, European Community CARDS Programme, 30 November 2001. Brussels, p. 58.

47 "State of Play of EU Accession process for Western Balkans Candidate and Potential Candidate countries" [http://www.europeanforum.net/uploads/news/wb\\_taskforce\\_on\\_eu\\_enlargement\\_background\\_briefing\\_country\\_overview\\_en.pdf](http://www.europeanforum.net/uploads/news/wb_taskforce_on_eu_enlargement_background_briefing_country_overview_en.pdf)

për "një histori sukcesi" të krahasueshme me atë të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, Shqipëria duket se ende ka për të bërë në drejtim të krijimit të një klime politike të shëndoshë dhe bashkëpunuese në vend, të forcimit të institucioneve dhe pavarësisë së tyre, si dhe për zhvillim ekonomik dhe integrimin në strukturat ekonomike rajonale dhe ato të vendeve anëtare të Unionit. Dhënia e statusit kandidat me kushtëzime, një risi kjo në praktikën e punës së BE-së, është një tregues i qartë i hendekut që ende ekziston midis aspiratës së shqiptareve për integrim dhe realitetit të realizimit të reformave.

## **Konkluzione**

Integrimin në institucionet euro-atlantike është një proces tërheqës edhe pse i vështirë. Tërheqës, sepse procesi i integrimin rrit shpirtin e ekipit, ndërsa rrit e rolin dhe statusin e Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. I vështirë, sepse ndarja e vlerave të përbashkëta është një proces që duhet mësuar. Procesin i integrimin inkurajon solidaritetin në mënyrë të tillë që larmia të projektohet si një pasurim i sistemit të vlerave të përbashkëta të komunitetit. Për më tepër, integrimi jep rezultate pozitive që pasqyrohen në treguesit ekonomik dhe social të zhvillimit të një vendi dhe marginalizim të atyre që nuk janë në gjendje për të vazhduar me dinamikën e integrimin.

Me gjithë ekzistencën e pengesave të shumta, e ardhmja e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë duket optimiste. Pranimi i vendeve të reja në Bashkimin Evropian në vitin 2004 zgjeroi zonën e ideve për një Evropë të përbashkët. Qasja e BE-së për ndërtimin e një Evrope të Bashkuar është e bazuar kryesisht në promovimin dhe nxitjen e demokracisë, të një ekonomie të tregut të qëndrueshme dhe shoqëri të zhvilluar demokratike dhe civile për të cilën padyshim aspirojnë edhe vendet e rajonit dhe Shqipëria. Megjithatë, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëria përballen me shumë sfida në udhëtimin e tyre drejt Evropës së Bashkuar. Duke qenë vende në tranzicion nga një rend komunist në atë demokratik duket se edhe për pak kohë mungesa e stabilitetit ekonomik, që lidhet ngushtësisht me tranzicionin politik dhe shoqëror do të jenë ende bashkëshoqëruese të rajonit. Tranzicioni nga diktatura në demokraci ofron mundësi për të gjitha llojet e ideve, por kur tradita demokratike mungon, siç është rasti i vendeve të rajonit, problemi qëndron në atë se si do të mbushet boshllëku ideologjik i krijuar pas përmbyesjes së komunizmit. Mohimi i vlerave

Në një kontekst të tillë, nuk duket e rastësishme që vendimmarrja politike në Shqipëri ende vuan nga konfliktualiteti, pasiguria dhe hezitimi, duke vepruar si frenues i proceseve të integritit, me ndikim në thellësinë dhe shpejtësinë e kryerjes së reformave, duke krijuar vështirësi serioze për procesin e integritit. Si pjesë e kësaj pamjeje të tranzicionit, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëria duhet të bëhen pjesë e aksioneve të përbashkëta me vendet e tjera të BE-së e me gjerë për të kapërcyer hendekun e sfidave të cilat duket se janë thelluar me zgjerimin dhe thellimin e krizës aktuale financiare në vendet e BE-së.

*(Botohet për herë të parë)*